



PROPOZIMI SHTETIWEB Për Reformën Administrative Territoriale

*Në Komisionin Parlamentar të
Reformës Administrative Territoriale
Maj 2014*

Objektivi sipas Programit të Qeverisë:

“Qeveria do ta vërë në zbatim ndarjen e re administrativo-territoriale të vendit në prag të zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe do ta shoqërojë atë me një paketë reformash fiskale dhe ligjesh mbështetëse, si dhe me ngritjen e mekanizmave konkrete për fuqizimin e njësive të reja vendore”

Pra, Reforma nuk do të jetë thjesht një riorganizim territorial i NJQV, por do të synojë **reformimin në tërësi** të qeverisjes vendore

Vizioni i Shtetiweb për Reformën

Qysh në nisje të konsultimeve bashkëbiseduesit e Shtetiweb kërkuan të dinë *Vizionin për Reformën*:

→ Si do të jetë struktura e QV?

→ Cilat do të jenë funksionet dhe përgjegjësitë e NJQV dhe financat që do të menaxhohen prej tyre?

Dokumenti i *Vizionit të Shtetiweb*, që nis nga analiza e Decentralizimit, shërbeu si bazë për të gjithë punën tonë.

Decentralizimi ka mbetur më shumë një objektiv se sa një realitet

- ✓ Prej vitit 2000 qeverisja vendore ende nuk është e aftë të ofrojë shërbimet e kërkuara nga banorët.
- ✓ Në gati 15 vjet transferimi i funksioneve, pronave, i financave drejt QV është i papërfunduar.
- ✓ Një hartë administrative-territoriale tepër të fragmentarizuar me 385 njësi të qeverisjes vendore.

Dekoncentrimi zëvendëson decentralizimin

- ✓ Sipas ligjit, QV ka 21 funksione të veta, funksionet e përbashkëta janë vetëm 6.
- ✓ Në qëndër qarku funksionojnë rreth 35 drejtori, zyra dhe inspektoriate.
- ✓ Në shkallë vendi funksionojnë rreth 1000 njësi të pushtetit qëndror të dekoncentruar, gati dy herë më tepër se strukturat e QV.
- ✓ Disproporcioni i financave për shërbimet publike midis QV dhe QQ është i skajshëm: 7% kundrejt 93%.

Reformat: Vendet e BE vs Shqipëri

- Synimi ynë strategjik është integrimi evropian, prandaj është legjitim referimi ndaj modelit të QV të vendeve evropiane.
- Referimi ndaj reformave të vendeve evropiane duhet të mbaj parasysh stadin në të cilin ndodhet QV dhe specifikat ekonomike e natyrore të vendit.
- Vendet e BE me QV të konsoliduar synojnë rritjen e eficiencës, kurse objektivi ynë kryesor është dhënia e funksioneve, përgjegjësi dhe financave të nevojshme për të shtuar shërbimet dhe cilësinë e tyre.

Shërbimet dhe Zhvillimi i Territorit

- Popullsia e vendit përqëndrohet kryesisht në *Qëndrat e banuara*, që zenë vetëm një pjesë të vogël të *Territorit* të tij. Në Qendrat e banuara nevoja për shërbimet ndaj banorëve del në plan të parë.
- Në *Territor* gjënden burimet natyrore dhe infrastruktura e nevojshme, që së bashku janë të nevojshme për zhvillimin ekonomik të vendit.
- QV apo “qeverisja në territor” organizohet për të kryer dy misione kryesore:
 1. Shërbimet ndaj banorëve
 2. Zhvillimin e qëndrueshëm të territorit

Nivelet e Qeverisjes Vendore

Në përputhje me këto misione, QV organizohet me nivele:

- ✓ Me disa nivele (2 apo 3)
- ✓ Me një nivel

Struktura më e zakonshme është ajo me disa nivele.

Në Shqipëri QV ka qënë dhe është e organizuar me disa nivele (2 dhe 3)

Qarku: A nevojitet?

Në strukturën e sotme të QV niveli i dytë – Qarku, përbën “pikën më të dobët”, për disa arsye:

- Funkzionet e tij nuk përcaktohen me ligj.
- Funkzioni i territorit është kryer nga QQ.
- Konceptimi i qarkut si koordinues midis QV dhe QQ është i gabuar.

Eksperienca negative e Qarkut nuk duhet të shërbej si argument për heqjen e nivelit të II të QV, në të kundërt.

Prapambetja dhe pabarazitë e zhvillimit të territorit – argument i rëndësishëm për rivlerësimin e këtij funksioni në organizimin e QV.

Ka një lidhje reciproke midis numrit të njësive në të dy nivelet

- Përcaktimi i strukturës së QV (niveleve) është i lidhur dhe ndikon direkt në konfigurimin e njësive në të dy nivelet.
- Nëse numri i njësive të nivelit të I do të jetë shumë i vogël (psh 40 njësi), është pa kuptim të flasim për nivelin e II. Në këtë rast “territori” përfshihet në njësitë e nivelit I.
- Organizimi i nivelit të II do të kishte kuptim nëse numri i njësive të nivelit të I do të ishte mbi një kufi, psh 75-80 njësi.

Propozimi Shtetiweb: 2 nivele

Sipas Shtetiweb, QV duhet të vazhdojë të jetë e organizuar në dy nivele:

- ✓ Niveli i I: Bashkitë, fokusohet kryesisht në shërbimet ndaj banorëve,
- ✓ Niveli i II: Rajonet (Qarqet), fokusohet kryesisht në zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

Propozimi me 2 nivele nuk kërkon ndryshime kushtetuese

“Seti” i kriterëve të përdorur nga Shtetiweb

“Seti” i kriterëve që Shtetiweb ka përdorur:

Numri i popullsisë,

Madhësia e territorit dhe distanca nga qendra e njësisë,

Tradita dhe zakonet,

Ekzistenca e një zone funksionale.

Kufijtë e rrethit dhe të komunës nuk janë “të pakalueshëm”.


Në qasjen tonë ne jemi bazuar gjithashtu në *vlerësimin dhe analizën e efijencës së funksionimit të NJQV.*

Eficienca e NjQV vlerësohet si:

- Pesha që zënë të ardhurat e veta të Njësive Vendore përkundrejt totalit të të ardhurave të tyre (AV/AT)
- Raporti mes:
 - a) shpenzimeve për paga & sigurime;
 - b) shpenzimeve korente;
 - c) shpenzimeve për investime,
- Pesha e të ardhurave nga taksa mbi tokën dhe mbi ndërtesat mbi totalin e të ardhurave vetjake.

Evolutioni i AV/AT 2008 - 2012

Raporti i të Ardhurave të Veta ndaj Totalit të të ardhurave (AV/AT), në % - rang vendi



Në shkallë vendi:

- 38 bashki dhe 44 komuna që realizojnë një raport të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave në masën mbi 40%. (Eficiente)
- 19 komuna dhe 37 bashki realizojnë nga 30-39% të ardhura të veta (Ndermjetme)
- 8 bashki dhe 227 komuna sigurojnë vetë nga 29% deri ne 0% të ardhura. (Ineficiente)

Bashkitë

- ✓ Reforma duhet të bëj shkrirjen e komunave dhe bashkive të vogla në njësi më të mëdha dhe me më shumë kompetenca, burime financiare dhe njerëzore, që të kryejnë shërbimet ndaj banorëve.
- ✓ Shtetiweb propozon krijimin e 88 Bashkive:
 - *kryesisht urbane*, (16 qytete kryesore bashkohen me territore në proces urbanizimi të komunave përreth),
 - *të përzjera urbane dhe rurale* (40 qytete të vogla bashkohen me komuna me identite të përafërta),
 - *tërësisht rurale*, (32 bashkime të disa komunave), kur plotësohen kriteret e më sipërme.


Nga 385 në 88 NJQV

Një paksim i tillë duhet konsideruar maksimal deri sa bën të mundur edhe organizimin e nivelit të II.

Në këtë mënyrë bëhet e mundur edhe ruajtja e identitetit të disa qëndrave të banuara apo komunave të mirënjohura, që për shkak të bashkimit të tyre do të zhdukeshin.

Organizimi i nivelit I në shkallë rrethi rrit së tepërmi distancën e të zgjedhurve nga banorët, krijon probleme në përfaqsimin proporcional të tyre, shton zyrat administrative, nuk ndikon në rritjen e eficiencës

% e NJQV inefficente në tre skenare: me 36 njqv, 88 njqv, 160 njqv



Qarqet (Rajonet)

- ✓ Qarqet të riorganizohen kryesisht sipas baseneve kryesore ujore të vendit dhe resurseve të tjera natyrore, për të siguruar me prioritet zhvillimin ekonomik të territoreve të tyre.
- ✓ Ristrukturimi i qarqeve të shërbej për të siguruar fondet strukturore dhe të kohezionit të BE-së dhe për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga programet e IPA-s, dhe iniciativa të tjera të destinuara për Ballkanin Perëndimor.

Qarqet (Rajonet)

Riorganizimi i qarqeve duhet t'u japë një drejtim të ri:

- ✓ hartimit dhe zbatimit të strategjive rajonale të zhvillimit;
- ✓ t'i hapë rrugë zgjerimit kompetencave të institucioneve dhe agjencive në nivel rajonal;
- ✓ të sjellë rritjen e burimeve financiare dhe asetëve për qarqet;
- ✓ të krijojë një model të ri dhe më efikas organizimi dhe funksionimi të autoriteteve qendrore dhe vendore në nivel rajonal.

Propozimi ShtetiWeb: 5 Qarqe

1. Qarqet Shkodër, Lezhë, Kukës
2. Qarqet Dibër, Tiranë, Durrës
3. Qarqet Fier, Berat
4. Qarqet Elbasan, Korçë
5. Qarqet Vlorë, Gjirokastrë

Tirana – Kryeqyteti – Status i Veçantë

Emrat e qarqeve sugjerojmë të jenë me përmbajtje historike.

www.shtetiweb.org

Ky është një prezantim i
“Propozimi Shtetiweb për reformën
territoriale”.

Deri në fund të muajit maj ne do të
vlerësojmë edhe sugjerimet që na vijnë
përmes Forumit tonë në website.

Ju falenderojmë për vëmëndjen tuaj